



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 393/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës-Blerim Grainca nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga radhët subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin (VV) 2513D/04D.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës-Blerim Grainca të subjektit politik LDK në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit kanë konstatuar se ka fituar vota, por këto vota gjatë plotësimit të formularit nuk ju kanë shënuar fare në numrin 76 dhe ky formular është dorëzuar i zbrazët ku me këtë rast thekson se është dëmtuar si kandidat. Parashtruesi i ankesës ka cekur se ky gabim ka ndodhë në QV.2513D, VV. 04D dhe kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit në VV 2513D/04D- Musa Bytyqi dhe kopjen e FRK-së.

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë: *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”, andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:*

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Blerim Grainca nga subjekti politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 76 votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV 2513D/04D dhe bartja e votave të tij tek kandidatja me numër 75.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2513D/04D për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 141717, 141718, 141715 dhe 141716 ndërsa shiriti i mesëm nr. 000409 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr. 005730.

PZAP-i, ka konstatuar nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 76 nga radhët e subjektit politik LDK nuk e posedon asnjë votë, ndërsa pas hapjes së kutisë nga PZAP-i dhe rinumërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin fjalë del se në kutinë e votimit 2513/04D janë 19 fletëvotime të vlefshme të kandidatit të lartpërmendur.

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 393/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*